



## ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi

**VENDIM**

*Nr.105, Datë 29.06.2020*

**MBI**

### **MIRATIMIN E ZYRTARIT TË PËRPUTHSHMËRISË (ZP) SË TAP DHE KONTRATËS PËR OFRIMIN E SHËRBIMEVE TË ZYRTARIT TË PËRPUTHSHMËRISË**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.43/2015 “Për Sektorin e Energjisë elektrike“, i ndryshuar, nenit 16 dhe 19 të Ligjit Nr.102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror” dhe nenit 15 të “Rregullores së Organizimit, Funkcionimit dhe Procedurave të ERE”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr.96, datë 17.06.2016, nenit 5 gërma c të “Rregullores për mbrojtjen e informacionit konfidencial”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE nr 65, datë 26.03.2018, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë ( ERE), në mbledhjen e tij të datës 29.06.2020, mbasi shqyrtoi relacionin dhe draftin e përgatitur nga Drejtoria e Gazit Natyror për Miratimin e Zyrtarit të Përputhshmërisë (ZP) të TAP AG,

#### **Duke patur parasysh që:**

- Në 18 Prill 2016, ARERA Italiane, Grekët RAE dhe ERE (RREGULLATORs) miratuan vendimin e tyre të fundit të përbashkët për çertifikimin e Trans Adriatic Pipeline AG (TAP) si një ITO që i nënshtrohet përmbushjes nga TAP AG të disa kushteve dhe detyrimeve;
- Programi i Pajtueshmërisë Rregullatore (RCP) është hartuar nga TAP AG për të ofruar një strukturë të brendshme standarte e cila ka për qëllim të sigurojë që, si Operator i Pavarur i Transmetimit, TAP AG dhe Punonjësit e tij, perfaqesuesit e aksionereve dhe Këshilltarët duhet të pajtohen me kërkesat si përcaktohet tek struktura rregullatore e TAP AG, përkatësisht Direktiva e Gazit, paragrafi 4.5.1 dhe 4.5.2 i Opinionit Përfundimtar të Përbashkët, Vendimi i Çertifikimit dhe dokumentat drejtues të korporatës, përfshirë Nenet e Shoqatës dhe Rregulloret Organizative
- Zyrtari i Pajtueshmërisë( ZP) emërohet nga Bordi i TAP sipas miratimit nga Autoritetet. Autoritetet mund ta refuzojnë miratimin e Zyrtarit të Pajtueshmërisë

vetëm për arsye të mungesës së pavarësisë ose aftësive profesionale. Kushtet të cilat udhëheqin mandatin ose kushtet e punësimit të Zyrtarit të Pajtueshmërisë, përfshirë kohëzgjatjen e mandatit të tij/saj, duhet të sigurojnë pavarësinë e Zyrtarit të Pajtueshmërisë dhe duhet të miratohen nga Autoritetet, në përputhje me Direktivën e Gazit dhe Ligjin Zvicerian të Punësimit.

- Në maj të vitit 2020, TAP AG dorëzoi pranë Rregullator-ve propozimin konkret për ZP të, duke përfshirë një përshkrim të shkurtër të rolit ZP dhe arsyetimin pse ky propozim është në përputhje me paketën e tretë të BE-së dhe Kërkesat e Direktivës 73/2009;
- Duke patur parasysh që TAP ofron kandidatin e ZP dhe kërkon miratimin e tij nga tre Rregullatorët e vendeve; Shqipëri, Greqi dhe Itali, duke paraqitur edhe dokumentacionin:

1- CV e kandidatit

2- Draftin e Deklaratës së Pavarësisë dhe projekt kontratës së punës, të cilat do të nënshkruhen nga kandidati pasi Rregullatorët të kenë lëshuar miratimin

3- Letër e lëshuar nga TAP AG që kërkon miratimin e kandidatit si ZP nga rregullatorët .

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Miratimin e Kontratës për Ofrimin e Shërbimeve të Zyrtarit të Përputhshmërisë së TAP
2. Miratimin e Zyrtarit të Përputhshmërisë (ZP) të TAP AG.
3. Ky vendim dhe dokumentat bashkëlidhur tij janë konfidenciale
4. Drejtoria e Çështjeve Ligjore të njoftojë palët e interesuara për vendimin e Bordit të ERE-S.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE-s**  
**Petrit AHMETI**